



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

PML.nr.103/2021

### NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar, Valdete Daka dhe Mejreme Memaj, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit B.Ll. nga fshati O. P., komuna e Gj., për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.1 nënpar.1.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë P.nr.139/2020 të datës 21.07.2020, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.798/2020 të datës 21.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më 22 prill 2021, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit B.Ll., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë P.nr.139/2020 të datës 21.07.2020, dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.798/2020 të datës 21.01.2021.

### A r s y e t i m i

Me aktgjykim të Gjykatës Themelore Gjakovë P.nr.139/2020 të datës 21.07.2020, i dënuari B.Ll. është shpallur fajtor për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.1 nënpar.1.3 të KPRK, dhe për këtë vepër penale është gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muajve në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 18.03.2020 e deri më datën 13.07.2020. I dënuari është obliguar që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajë shumën prej 70 €, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor dhe kompensimit të viktimave të krimit të paguajë nga 30 €, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. I dëmtuari J.T. për realizimin e kërkesës pasurore- juridike është udhëzuar në kontest civil.

Në procedurën ankimore me aktgjykim të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.798/2020 të datës 21.01.2021, janë refuzuar ankesat e palëve, ndërsa aktgjykimi i shkallës së parë është vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit avokati Arbër Guta nga Gjakova, duke mos cekur bazat ligjore të shkeljeve të pretenduara me propozim që kërkesa të aprovohet dhe aktgjykimet të ndryshohen në kuptim të pretendimeve të kërkesës.

Prokurori i Shtetit me parashtresën KMLP.II.nr.71/2021 e datës 30.03.2021, ka propozuar që të refuzohet si e pabazë kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e çështjes në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet në kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë dhe konstatoi se:

Kërkesa është e pabazuar.

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit avokati Arbër Guta edhe pse nuk cek bazën ligjore për shkak të cilave kontestohen aktgjykimet nga kërkesa mund të konkludohet se kërkesa është paraqitur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale me pretendimin se gjykata e shkallës së parë nuk i ka vërtetuar faktet dhe rrethanat në të cilat e ka bazuar dënimin dhe se në arsyetim të gjykatës janë cekur rrethanat rënduese si pesha e veprës penale dhe se të dëmtuari i ka shkaktuar lëndim të rëndë trupor, rrethana këto të cilat nuk janë të parapara në dispozitat që përcaktojnë rregullat e përgjithshme për zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Po ashtu mbrojtësi konsideron se i dënuari ka pranuar fajësinë dhe ky pranim është dashur të vlerësohet si rrethanë posaçërisht lehtësuese dhe ndaj të njëjtit është dashur të aplikohet zbutja e dënimit në kufij të përcaktuar me nenin 72 të KPK, e çka është anashkaluar nga gjykata e shkallës së parë.

Gjykata Supreme konstatoi se me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë të dënuarit i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muajve, dhe në atë rast gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 69 dhe 70 të KPK.

Konform dispozitës së nenit 385 par.1 nënpar.1.5 të KPPK, kur është fjala për vendimin mbi dënimin, shkelja e ligjit penal bëhet kur në marrjen e vendimit për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me vepër penale, gjykata ka tejkaluar kompetencat ligjore.

Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënimin e paraparë për këtë vepër penale, ndërsa duhet të theksohet se është në diskrecionin e gjykatës vlerësimi i rrethanave në çdo rast konkret e përveç kësaj janë dhënë arsye ligjore të cilat kanë ndikuar në shqiptimin e dënimit si dhe të njëjtat arsye kanë qenë të pranuar për gjykatën e shkallës së dytë e cila e ka aprovuar dënimin e shqiptuar, prandaj as në këtë drejtim nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Pretendimi në kërkesë se dënimi i shqiptuar me dënim jo adekuat të rrethanave të rastit konkret nuk paraqet shkelje të ligjit penal e as që është bazë për ushtrimin e këtij mjete të jashtëzakonshëm juridik.

Nga të gjitha këto që u tha më lartë kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë u konsiderua si e pabazë dhe konform nenit 437 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA ASUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Pml.nr.103/2021, më 22 prill 2021

Procesmbajtësi,  
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,  
Agim Maliqi